



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ . ____ .2024

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr.10 416, datë 7.4.2011 “PËR
MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi:

- a) “furnizues” zëvendësohet me “operator profesionist”,
- b) “fillestar” zëvendësohet me “para-bazë”
- c) “Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRKK)” zëvendësohet me “Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)”,

d) “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ose AKU” zëvendësohet me “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, me përjashtim të shkronjës a) të pikës 2 të nenit 11 dhe pikës 1 të nenit 13.

Neni 2

Në nenin 3, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 riformulohet si vijon:

“6. Inspektim” është çdo lloj kontrolli i kryer nga Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve gjatë fazës së prodhimit deri në çertifikim”.

2. Pika 7 riformulohet si vijon:

“7. Inspektor” është punonjësi i inspektoratit që mbulon fushën përkatëse pranë Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve, të ngarkuar për kontrollin e zbatimit të këtij ligji.

3. Pas pikës 12, shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:

“12/1. Material mbjellës i çertifikuar jo përfundimisht” është një varietet, është i regjistruar në KK por jo i ambalazhuar dhe i etiketuar, pasi importohet rifuxho.

Neni 3

Shkronja “a” e pikës 7, të nenit 4 riformulohet si vijon:

“a) Varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar, me përjashtim të neneve 6 dhe 10 të këtij ligji”.

Neni 4

Pika 2 e nenit 5, shfuqizohet.

Neni 5

Në pikën 2 të nenit 7, në pikën 3 të nenit 15, në pikën 4 të nenit 17, në pikën 1 të nenit 18 dhe në pikën 5 të nenit 19, fjalët “...përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit” zëvendësohen me fjalët “...miratohen me udhëzim Ministri”.

Neni 6

Pika 3 e nenit 10 riformulohet si vijon:

“3. Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, ESHFF-ja lejon tregtimin nëse rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është i regjistruar”.

Neni 7

Në nenin 11, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

“a) në shkronjën “b” shprehja “AKU-së” zëvendësohet me shprehjen “Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve”.

“b) Në shkronjat “dh” dhe “e”, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “për certifikim”.

2. Pika 5 riformulohet si vijon:

“5. Cdo person juridik ose fizik që kërkon të ushtrojë një veprimtari së prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor , paraqet pranë ESHFF-së dokumentacionin, si vijon:

a) Diplomë bachelor ose master të drejtuesit Teknik në fushën e agronomisë;

b) Kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit Teknik”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me përmbajtjen si vijon:

“9. Çdo 6 muaj furnizuesi kryen rianalizimin për fuqinë mbirëse për materialin mbjellës shumëzues bimor të vendosur në treg”.

Neni 8

Në pikën 1 të nenit 13, shprehja “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” zëvendësohet me shprehjen “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve”.

Neni 9

Pika 4 e nenit 16 riformulohet si vijon:

“4. Procedura të tjera për certifikimin zyrtar, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, certifikatës së materialit mbjellës dhe mënyra e njoftimit të drejtuesit të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, miratohen me udhëzim Ministri”.

Neni 10

Pika 1 e nenit 23, riformulohet si vijon:

“1. Të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor e ka çdo person juridik ose fizik, që paraqet dokumentacionin pranë Institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg, si më poshtë vijon:

a) Diplomë bachelor ose master të drejtuesit Teknik në fushën e agronomisë;

b) Kontratë pune me kohë të plotë të drejtuesit Teknik”.

Neni 11

Pika 4 e nenit 24, riformulohet si vijon:

“4. Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor lidhur me plotësimin e kërkesave të përcaktuara për tregtim në këtë ligj, kryhet në bazë të planit vjetor të kontrolleve zyrtare dhe marrjes së mostrave me bazë rrisht, të miratuar me urdhër Ministri”.

Neni 12

Pika 1 e nenit 26 riformulohet “Importi për raste emergjente i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhet me autorizim të veçantë të ministrit”.

Neni 13

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjaët "...të cilat i boton në buletin e saj zyrtar" hiqen;
2. Pika 3 riformulohet si vijon:
"3. Katalogu Kombëtar publikohet në faqen zyrtare të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Ministrisë dhe përditësohet sa herë që pëson ndryshime. Forma, dhe përmbajtja e Katalogut Kombëtar miratohen me urdhër Ministri".

Neni 14

Neni 30 riformulohet si vijon:

"Neni 30

Kërkesa për regjistrimin e një varieteti

1. Kërkesa për regjistrimin e një varieteti kryhet në sistemin *on-line* në platformën ndërqeveritare e-albania dhe përmban:
 - a) dokumentin që vërteton provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS);
 - b) deklaratën në rastet kur kërkesa bëhet për regjistrimin e një varieteti të një fare bari, që nuk ka destinacion prodhimin foragjer, ose për një varietet të përcaktuar për përdorim vetëm si komponent gjenetik për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve apo i një varieteti, i cili është OMGJ;
 - c) mandatin e pagesës.
2. Të dhënat e kërkuara nga kërkuesi për origjinën e varietetit trajtohen si të dhëna konfidenciale.

Neni 15

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:
"1. Regjistrimi i varietetit në Katalogun Kombëtar kryhet nëse plotësohen këto kushte:
 - a) vërtetohet se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, është miratuar si varietet i ri dhe është caktuar personi përgjegjës për ruajtjen e tij;
 - b) vërtetohet e drejta për përdorimin e këtij varieteti;
 - c) plotëson standardet e pranueshme për vlerën e kultivimit dhe përdorimit, të miratuara me vendim të KRV-së".
2. Pika 2 riformulohet si vijon:
"2. Një varietet që është OMGJ regjistrohet vetëm nëse plotëson kushtet e specifikuar në pikën 1 të këtij neni, dhe nëse pranimi ose mbajtja e një varieteti të tillë nuk bie në kundërshtim me legjislacionin përkatës për OMGJ-të".

Neni 16

Fjalja e parë e pikës 2 të nenit 33 riformulohet si vijon:

"2. Në qoftë se kërkuesi deklaron në kërkesë se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet dhe është miratuar si varietet i ri në Republikën e Shqipërisë ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian a në një nga shtetet nënshkruese të konventës së UPOV-it, testimi mundet të mos kryhet me kusht që furnizuesi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkon të testojë të paraqesë në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

dokumentacion zyrtar, nëpërmjet të cilit vërtetohen karakteristikat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (Skedën), dhe provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS)”.

Neni 17

Neni 35 riformulohet si vijon:

“Neni 35

Regjistrimi i varietetit në Katalogun Kombëtar

1. Komisioni i Regjistrimit të Varietetit, (KRV), sipas vlerësimit të dërguar nga ESHFF për vlerën e kultivimit dhe përdorimit (VKP) dhe të DUS, vendos për regjistrimin ose jo të varietetit në Katalogun Kombëtar;
2. Kostoja financiare e krijuar për regjistrimin e varietetit përballohet nga furnizuesi”.
3. Procedura dhe afatet e vlefshmerisë së regjistrimit të një varieteti në Katalogun Kombëtar miratohet me udhëzim Ministri”.

Neni 18

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “c” të pikës 1, akronimi “KVVRKK” zëvendësohet me akronimin “ESHFF”;
2. Pika 2 riformulohet si vijon: “2. Vendimi për çregjistrimin merret nga Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)”;
3. Pika 3, shfuqizohet.

Neni 19

Neni 37 riformulohet si vijon:

“Neni 37

Rinovimi i regjistrimit të një varieteti

1. Kërkesa për rinovimin e regjistrimit të një varieteti kryhet *on line*. Kërkuesi konfirmon që vazhdon plotësimin e kriterëve të regjistrimit të parë të varietetit.
2. Miratimi i rinovimit të regjistrimit kryhet direkt nga Komisioni i Regjistrimit të Varietetit (KRV)”.

Neni 20

Në pikën 1, të nenit 39, fjala “të listuar” zëvendësohet me fjalën “të regjistruar”.

Neni 21

Neni 40 riformulohet si vijon:

“Neni 40

Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV)

1. Komisioni i Regjistrimit të Varieteteve (KRV) është organ kolegjal teknik, i përhershëm dhe vendimmarrës, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të varieteteve.

2. Përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Regjistrimit të Varieteteve (KRV-së), miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.
3. Anëtarët e komisionit miratohen me urdhër të ministrit, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.
4. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën MMSHB-së. Ata, paraprakisht, duhet të deklarojnë marrdhëniet, nëse kanë, me subjektet e prodhimit apo tregtimit të MMSHB-së.

Neni 22

Në pikën 1 të nenit 41 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a”, riformulohet si vijon:
“a) të ndjekë procedurat për regjistrimin e varieteteve”;
2. Shkronja “e”, riformulohet si vijon:
“e) të analizojë mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të vendosura në treg, të sjella nga Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar për vendosjen në treg si dhe subjektet private”;
3. Pas shkronjes e) shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:
“ë) të publikojë KK në faqen zyrtare”.

Neni 23

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit riformulohet: “Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar”;
2. Pika 1 riformulohet si vijon:
“1. Detyrat e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë:”
3. Shkronja “a”, e pikës 1 riformulohet si vijon:
“a) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet e tregtohet”;
4. Në shkronjën “c”, të pikës 1, hiqet fjala “të importuar”.

Neni 24

Neni 43 riformulohet si vijon:

“Neni 43

Veprimtari të ndaluara

1. Ndalohet prodhimi dhe vendosja në treg i:
 - a) materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të paregjistruar në katalogun kombëtar, me përjashtim të rasteve që parashikohet ndryshe në këtë ligj;
 - b) kryerjes së veprimtarive të prodhimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 11 si dhe me pikën 1 të nenit 23, të këtij ligji.
2. Ndalohet përkohësisht tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili nuk është ambalazhuar dhe etiketuar sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij”.

Neni 25

Pika 2 e nenit 44, riformulohet si vijon:

“2. Laboratori i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, sipas metodikave të Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farërave (ISTA)”.

Neni 26

Pika 1 e nenit 55, riformulohet si vijon:

“1. Të drejtën e vendosjes së masës administrative, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Institucionit përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor në treg dhe Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të shëndetit të bimëve”.

Neni 27

Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit Nr. 10416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar do të zbatohen deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të parshikuara në nenet .